



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË

Datë 22.09.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rikonstruksion i kanaleve ujtese të fushës së Korçës”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për kanale ujtese 45247111-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

24,857,236 (njëzet e katër milionë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

Ky objekt është parashikuar të financohet nga Buxheti i Shtetit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **BASHKIA KORÇË** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros te jete jo më e vogel se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet. që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2.b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne **ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat**), Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

*AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje **Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”**: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.*

2.1.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023,2024,2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.10091,date 05.03.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, Kreu V, neni 41.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilanci e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pikë 3, e LPP, si dhe nenin 43, pikë 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht se “4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vjetet e fundit financiarë, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy balance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci/en të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë balance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilanci e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligji Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar Nenit 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar ku përcaktohet se : “Njësitë ekonomike që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare: Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilanci në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël”

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël** se 50 % e vlerës së përllëgoaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

- a) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: **”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Lidhur me dokumentacionin e kerkuar për vertetimin e punëve të ngjashme janë kerkuar keto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se: **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.**

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

Në kuader të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktimit, vlerësimi i përvojës të mëparshme të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkepunimit apo marrëveshjes së nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Dokumenta keto të nevojshme për të vlerësuar lidhur me punët konkrete që ka kryer OE si anëtar i BOE, apo si nënkontraktor. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Përcaktimi i vlerës së kerkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore të sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qellim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Kategoria	Klasifikimi	Emertimi i kategorise
N.P - 7	B	Ujësjiellësi, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje.
N.P – 1	A	Punime gjurmimi në tokë.
N.S – 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrim i i kategorisë sipas legjislativit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P – 7	Ujësjiellësi, gazsjellës,	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni	B, 21- 50 milion lek	20,864,650.25

	vajsjellës, vepra kullimi e vadtje.	Prerje bime te vogla $\varnothing \sim 10\text{cm}$ Porte metalike me mekanizem ngrites me krahe Fugature llac cemento M - 50, Mur guri Shkulje rrenjeve bimeve te vogla Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km Nenshtrese zhavori Struktura monolite betoni C 16/20 Struktura te holla monolite betoni C 16/20 Porte metalike me mekanizem ngrites me krahe Fugature llac cemento M - 50, Mur guri		leke Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e madhe se 20 milion
N.P – 1	Punime gërmimi në tokë.	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m^3 , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke te zakonshme Rrafshim skarpate ne germim, ekskavator 0.5 m^3 Germim kanalesh ne toke te bute, me krahe, me seksion deri 0.75 m^2	A, 0-20 milionë lekë	1,337,966.83 leke Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion
N.S - 1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prishje struktura prej betoni	A, 0-20 milionë lekë	1,470,938.94 leke Vlera e punimeve te parashikuara ne preventiv dhe qe

				perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion
N.S – 18	Punime topogjeode zike	Kërkesa për disponimin e licencës profesionale N.S.-18 – Punime topogjeodezike justifikohet nga natyra dhe mënyra e realizimit të objektit të kontratës, pasi punimet topografike përbëjnë një veprimtari të nevojshme për zbatimin e saktë të punimeve të rikonstruksionit të kanaleve ujitëse. Megjithëse punimet topografike nuk janë paraqitur si zë i veçantë në preventiv, ato janë të parashikuara në projektin teknik dhe specifikimet teknike dhe lidhen drejtpërdrejt me piketimin, përcaktimin e kuotave, kontrollin e niveleve dhe verifikimin e përputhshmërisë së punimeve të realizuara me projektin. Për shkak se zbatimi i punimeve të kanalit, gërmimeve, skarpave, strukturave prej betoni, tombinove dhe elementeve të tjera hidraulike kërkon përcaktim dhe kontroll topografik gjatë fazave të zbatimit, disponimi i kapaciteteve profesionale për punime topogjeodezike konsiderohet i nevojshëm për garantimin e realizimit të objektit në përputhje me projektin teknik dhe kërkesat e specifikimeve teknike.	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve të parashikuara në preventiv dhe që perfshihen ne kete kategori eshte me e vogel se 20 milion

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave si më poshtë:

- **Inxhinier Hidroteknik 1 (një)**
- **Inxhinier Ndërtimi 1 (një)**
- **Inxhinier Topograf 1 (një)**

Per te vertetuar personelin kryesor duhet:

I.diploma

II- kontrata e punes

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësura me origjinalin”.

Argumentimi kërkesa 2.2.3

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj”, VKM Nr 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin kryesor të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të zberthimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Kërkesa per drejtuesin teknik “**Inxhinier Hidroteknik**”, “**Inxhinier Ndërtimi**” dhe “**Inxhinier Topograf**” eshte vendosur duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendimin Nr.312, datë 5.5.2010”Për miratimin e rregullores "për sigurinë në kantier,Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”,i ndryshuar.

Përgjegjësitë e stafit teknik: Inxhinieri Hidroteknik do të jetë përgjegjës për drejtimin dhe kontrollin teknik të elementeve hidraulike të veprës dhe për garantimin e funksionalitetit të infrastrukturës ujitëse; **Inxhinieri i Ndërtimit** do të jetë përgjegjës për drejtimin dhe kontrollin e punimeve konstruktive dhe ndërtimore, përfshirë punimet e betonit dhe betonarmesë, hekurit, mureve, gabioneve dhe punimeve të tjera ndërtimore; ndërsa **Inxhinieri Topograf** do të jetë përgjegjës për piktimin, kontrollin e akseve, kuotave, dimensioneve dhe matjeve topografike gjatë zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin dhe specifikimet teknike.

Profili	Përgjegjësia kryesore	Punimet që mbulon
Inxhinier Hidroteknik	Funksionimi hidraulik i veprës	Kanalet ujitëse, seksioni dhe kuotat hidraulike të kanalit, tombinot, rrjedhja/shpërndarja e ujit, portat metalike me mekanizëm ngritës dhe kontrolli që ndërhyrjet të rikthejnë funksionalitetin e sistemit ujitës
Inxhinier Ndërtimi	Zbatimi konstruktiv dhe cilësia e punimeve ndërtimore	Prishjet e betonit, strukturat C16/20, betonarmeja, hekuri, kallëpet, muret me gurë, gabionat, hidroizolimet, fugaturat, nënshtresat dhe kontrolli i materialeve
Inxhinier Topograf	Saktësia gjeometrike dhe topografike e zbatimit	Piketimi, kuotat, aksat, dimensionet, profilet e kanalit, kontrolli i niveleve, matjet e volumeve dhe ruajtja/rikontrolli i pikave dhe shenjave topografike

2.2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **23 persona**, dokumentuar kjo me vertetimin e pageses së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punesimi.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia
Kamion me kapacitet mbajtes deri ne 5 ton, me autovinc	cope 2	ne pronesi ose me qera
Kamion me kapacitet 5-10 ton	cope 3	ne pronesi ose me qera
Eskavator me goma	cope 2	ne pronesi ose me qera
Betoniere	cope 3	ne pronesi ose me qera

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike duhet te paraqiten dokumentat si më poshtë :

-Ne rast se mjeti eshte ne pronesi te paraqiten: certifikata e pronesise, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

-Ne rast se mjeti eshte me qera te paraqiten: kontrata e qerese vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit, certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe çertifikatë për transport mallrash brenda vendit, per mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

(Ne rastin e mjeteve te marra me qira nga operatorët ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022, referuar dokumentacionit (leje qarkullimi, çertifikate e transportit te mallrave), mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet)

-Per mjetet dhe pajisjet e tjera qe nuk shenohen ne regjistra publik ofertuesi duhet te paraqesë dokumente qe vertetojne pronesine e mjeteve/pajisjeve dhe ne rast se jane me qera duhet kontrata e qerese vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi e shoqeruar me dokumentacionin qe verteton pronesine e tyre.

Kjo kërkesë do të quhe e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi kriteret 2.2.4 dhe 2.2.5:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç ku përcaktohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **fuginë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit**” dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku

përcaktohet se „Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**“

Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin minimal të punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” dhe gjithashtu edhe bazuar edhe në rekomandimin e APP Nr 1797/1 datë 10.03.2022 janë parashikuar orët e punës për secilin zë punimesh sipas tabelës bashkelidhur dhe bazuar edhe në afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve është përcaktuar **numri minimal i punonjësve të domosdoshëm për realizimin e punimeve.**

Numri i fuqisë punëtore është llogaritur në baze të zërthimit të grafikut të punimeve, zërthimit të preventivit dhe natyrës së objektit, numri prej 23 personash përfshin personelin kryesor drejtues teknik, staf mbështetës, punonjës të specializuar/të kualifikuar dhe punëtorë të tjerë për llogaritje nga zërthimi i preventivit, grafikut të punimeve dhe natyrës së objektit.

Konkretisht nga llogaritjet e bera nga specialisti i fushës rezulton se:

Sasia totale e oreve të punës sipas manualit dhe analizave teknike për çdo zë të preventivit është 20,639.21 ore. Llogaritja e numrit të punonjësve në varesi të oreve të punës dhe afatit të kontratës është si më poshtë:

Totali orë pune + orë makineri	20,639.21
Ditë pune (orë pune/8)	2,579.90
Specialiste+punetore për 6 muaj	20
Ing. Hidroteknik	1
Ing. Ndërtimi	1
Ing. Topograf	1
Numri i punëtorëve gjithsej	23

Lidhur me mjetet edhe pajisjet teknike:

Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës Ky kriter u vendos duke patur parasysh natyrën dhe volumin e punimeve të parashikuara në preventiv.

Gjithashtu bazuar në nenin 28 të Udhëzimit Nr.15, datë 24.7.2007” PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR” i ndryshuar,” Kamionët me kapacitet transportues nën 1500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit”

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia	Argumentimi
Kamion me kapacitet mbajtes deri në 5 ton, me autovinc	cope 2	ne pronesi ose me qera	Kërkesa për 2 (dy) kamionë me kapacitet mbajtës deri në 5 ton, të pajisur me autovinc, lidhet me nevojën për transportin, ngarkimin, shkarkimin dhe pozicionimin e materialeve dhe elementeve të ndryshme të përdorura gjatë zbatimit të punimeve. Në preventiv parashikohen tombino me tuba betoni Ø600, portë metalike me mekanizëm ngritës, materiale ndërtimi dhe elemente të tjera që kërkojnë jo vetëm transport, por edhe manipulim dhe pozicionim në kantier. Pajisja me autovinc mundëson ngarkimin dhe shkarkimin e elementeve dhe materialeve në kushtet e kantierit, veçanërisht në segmentet e kanalit ku aksesit dhe mundësia e përdorimit të mjeteve të tjera ngritëse mund të jenë të kufizuara. Disponimi i 2 mjeteve krijon mundësi për furnizimin dhe manipulimin e materialeve në më shumë se një front pune, duke reduktuar nevojën për zhvendosje të vazhdueshme të mjetit ndërmjet 5 vendndodhjeve dhe duke garantuar vijueshmërinë e punimeve.

Kamion me kapacitet 5-10 ton	cope 3	ne pronesi ose me qera	Kërkesa për 3 kamionë me kapacitet mbajtës 5–10 ton lidhet me nevojën për transportin e dherave dhe materialeve ndërtimore gjatë realizimit të punimeve në 5 vendndodhjet e ndryshme. Në preventiv parashikohet zëri “Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km”, me volum 111 m³, si dhe punime gërmimi, mbushjeje, rrafshimi, ngjeshjeje dhe realizimi të nënshtresave. Përveç transportit të dherave, kamionët do të përdoren për furnizimin e fronteve të punës me zhavorr dhe materiale të tjera ndërtimore. Duke qenë se punimet zhvillohen në 5 objekte të veçanta dhe në vendndodhje të ndryshme, disponimi i 3 kamionëve mundëson organizimin e transportit në mënyrë të koordinuar dhe, sipas nevojës së grafikut të punimeve, në fronte të ndryshme pune, duke shmangur ndërprerjet që do të shkaktoheshin nga përdorimi i një numri të kufizuar mjetesh.
Eskavator me goma	cope 2	ne pronesi ose me qera	Kërkesa për 2 eskavatorë me goma justifikohet nga natyra e punimeve të parashikuara, të cilat përfshijnë gërmimin e kanaleve, gërmimin e dheut, rrafshimin e skarpatave dhe sistemimin e terrenit. Duke qenë se kemi të bëjmë me 5 kanale në vendndodhje të ndryshme, përdorimi i 2 eskavatorëve mundëson krijimin e fronteve të ndryshme pune dhe realizimin e punimeve të gërmimit e të sistemimit në mënyrë më të njëtrajtshme, pa

			qenë e nevojshme që i njëjti mjet të zhvendoset vazhdimisht ndërmjet të gjitha vendndodhjeve.
Betoniere	cope 3	ne pronesi ose me qera	Kërkesa për 3 betoniere lidhet me volumin e konsiderueshëm të punimeve të betonit dhe faktin që këto punime do të realizohen në 5 kanale të ndryshme. Në preventiv parashikohen: struktura monolite betoni C16/20; struktura të holla monolite betoni C16/20, pra një volum betoni për të cilin disponimi i 3 betoniereve krijon kapacitet për përgatitjen dhe furnizimin e vazhdueshëm me beton në fronte të ndryshme pune, veçanërisht në kushtet kur strukturat prej betoni realizohen në objekte të shpërndara në vendndodhje të ndryshme. Kjo shmang ndërprerjet e procesit të betonimit dhe nevojën për zhvendosjen e vazhdueshme të një pajisjeje të vetme ndërmjet 5 objekteve.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Dokumentacioni teknik ku përfshihen **projekti teknik, relacioni teknik, preventivi, grafiku i punimeve, specifikimet teknike**, për këtë objekt janë dorëzuar nga **Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës**, dhe hartuar nga Nderrmarja e Sherbimeve Publike, pranë Bashkisë Korçë, në përputhje me detyrat e saj funksionale.

Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b, dhe nenit 36 të LPP (e ndryshuar), si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit” i ndryshuar.

Në çdo rast nëse janë përmendur marka prodhimi, burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalenti i tij/saj.

Gjate hartimit të specifikimeve teknike janë marrë në konsideratë kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat perkatëse të përcaktuara në aktet në ligjore në fuqi në fushën e ndërtimit.

Fondi limit i përlogaritur për këtë procedurë është hartuar në bazë të VKM-se nr.26 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të cmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

Për sa i përket specifikimeve teknike, lihet mundësia të paraqitet dhe standartet SSH/UNI/EN/ISO, sipas rastit që aplikohet.

NJESIA E PROKURIMIT